

## **AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI**

### **I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

#### **“HORIZON LIGHT INVESTMENTS” Sh.P.K.**

Në Sarandë, sot më datë 17.06.2022, në përputhje me dispozitat e Ligjit 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, me vullnetin tim të plotë dhe të lirë, unë e nënshkruara:

- Erina MISHA, e bija e Ilia, e datëlindjes 29 Nëntor 1981, lindur në Leskovik dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit No.033942004 dhe numër personal I16129034P me datë lëshimi 13/02/2019, në cilësinë e ortakut të vetëm, me vullnet të lirë dhe të plotë, përmes këtij akti, themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe këtë akt si vijon:

Neni 1

#### **EMËRTIMI**

Shoqëria quhet **“HORIZON LIGHT INVESTMENTS” sh.p.k** (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar)

Neni 2

#### **FORMA JURIDIKE**

" HORIZON LIGHT INVESTMENTS " Sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe që ushtron veprimtari në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe në veçanti me dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar dhe në përputhje me këtë akt.

Neni 3

#### **SELIA E SHOQËRISË**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në Sarandë, Lagjia 4, Rruga Mithat Hoxha, Nr. 27, Sarandë. Me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm, selia e shoqërisë mund të transferohet në një rajon tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë apo dhe jashtë tij.

Neni 4

#### **KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE**

4.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon që prej datës së regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

4.2 Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të përcaktohen përmes vendimit të Ortakut të Vetëm, në përputhje me dispozitat e këtij akti dhe legjislacionit në fuqi.

## Neni 5

### **OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

1. Investitor në fushën e ndërtimit
2. Agjensi imobiliare

Në përgjithësi, Shoqëria mund të ushtrojë cdo veprimtari tjetër tregtare dhe prodhuese e cila nuk ndalohet me ligj, për realizimin e objektit të Shoqërisë.

## Neni 6

### **KAPITALI I SHOQËRISË**

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën e 10,000 lekë (dhjetë mijë).
- 6.2 Kapitali themeltar përbëhet nga 1 (një) kuotë, me vlere nominale 10,000 leke (dhjete mijë).
- 6.3 Kapitali i shoqërisë është nënshkruar dhe e pashlyer plotësisht.

## Neni 7

### **ORTAKU I VETËM**

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është:

- **Znj. Erina Misha**, shtetase shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit No.033942004 dhe numër personal I16129034P, zotëruese e 1 (një) kuotë që i korrespondon 100% (një qind përqind) të kapitalit të Shoqërisë, në vlerën 10.000 lekë (dhjete mijë).

## Neni 8

### **ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR**

- 8.1 Kapitali i themeltar mund të zmadhohet në çdo kohë, në një ose me shumë këste, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me vendim të Ortakut të Vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 8.2 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar, me vendim të Ortakut të Vetëm në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në çdo rast, kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e përcaktuar në ligj.

## Neni 9

### **TRANSFERIMI I KUOTËS**

Ortaku i Vetëm mund të vendosë në çdo kohë për transferimin e kuotës përmes shitjes, dhurimit, trashëgimisë apo ndonjë mënyre tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

## Neni 10

### **VENDIMARRJA**

- 11.1. Organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë është Ortaku i Vetëm.
- 11.2 Ortaku i Vetëm është përgjegjës ndër të tjera për vendime në lidhje me çështjet e mëposhtme:
- i. ndryshimi i statutit;
  - ii. emërimi dhe shkarkimi i administratorëve, eksperteve kontabël dhe likuidatorëve dhe shpërblimi i tyre;
  - iii. zmadhimi dhe/ose zvogëlimi i kapitalit;
  - iv. transferimi i kuotës;
  - v. shpërndarja e fitimit;
  - vi. riorganizimi dhe/ose likuidimi i Shoqërisë; dhe
  - vii. çdo çështje tjetër të parashikuar nga legjislacioni i zbatueshëm dhe ky akt.

## Neni 11

### **REGJISTRI I VENDIMEVE**

- 11.1 Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, vendimet për:
- i. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ii. zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar;
  - iii. shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
  - iv. investimet;
  - v. vendimet për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.
- 11.2 Lista e mësipërme nuk është shteruese dhe vendimet e paregjistruara në Regjistrin e Vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

## Neni 12

### **ADMINISTRIMI**

- 12.1 Shoqëria do të administrohet nga një ose më shumë administratorë. Administrator i parë i Shoqërisë për një afat 5 vjecar duke filluar nga data e nënshkrimit të këtij akti është:
- Erina MISHA, e bija e Ilija, e datëlindjes 29 Nëntor 1981, lindur në Leskovik dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit No.033942004 dhe numër personal I16129034P me datë lëshimi 13/02/2019.
- 12.2 Administratori/ët do të emërohen me vendim të Ortakut të Vetëm dhe mund të shkarkohen në çdo kohë me një vendim të njëjtë.

- 12.3 Administratori/ët është person fizik, pa ndonjë kufizim në lidhje me shtetësinë. Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit/ëve do të vendoset në momentin e emërimit, por në çdo rast nuk mund të tejkalojë afatin 5 (pesë) vjeçar. Pavarësisht këtij kufizimi, kohëzgjatja e mandatit mund të ripërtërihet me anë të vendimit të Ortakut të Vetëm.

#### Neni 13

### **KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

- 13.1 Administratori është përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe përfaqëson Shoqërinë me të palët e treta, në përputhje me dispozitat e këtij akti dhe legjislacionin e zbatueshëm.
- 13.2 Kompetencat dhe detyrat e Administratorit në lidhje me administrimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të Shoqërisë përfshijnë, por nuk do të kufizohen në:
- i. zbatimin e politikave të biznesit të Shoqërisë dhe vendimet e Ortakut të Vetëm;
  - ii. sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi dhe standardeve të kontabilitetit të Shoqërisë;
  - iii. kryerjen e të gjitha veprimet në lidhje me administrimin e veprimtarisë së biznesit të Shoqërisë;
  - iv. mirëmbajtjen e rregullt të dokumenteve financiare dhe kontabël të Shoqërisë;
  - v. përfaqësimin e Shoqërinë me palët të treta;
  - vi. kryerjen e gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, bazuar në legjislacionin në fuqi;
  - vii. kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në ligj dhe në këtë akt.
- 13.3 Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat dhe veprimet, me përjashtim të atyre që me ligj dhe nga ky akt janë të rezervuara për Ortakun e Vetëm ose kufizohen nga ky akt apo legjislacioni i zbatueshëm.
- 13.4 Administratori mund të delegojë pjesë ose tërë kompetencat e tij tek persona të tjerë.

#### Neni 14

### **EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR**

Nëse kërkohet me ligj ose miratohet nga Ortaku i Vetëm, kontrolli i pasqyrave financiare dhe të dhënave kontabël të Shoqërisë do t'i besohet një ose më shumë eksperteve kontabël të autorizuar.

#### Neni 15

### **VITI USHTRIMOR DHE PASQYRAT FINANCIARE**

- 15.1 Viti ushtrimor fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor të çdo viti.
- 15.2 Viti i parë ushtrimor do të fillojë ditën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe do të mbarojë me 31 Dhjetor 2022.

- 15.3 Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar, nëse ka një të tillë, miratohen nga Ortaku i Vetëm në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.
- 15.4 Miratimi i dokumenteve në lidhje me pasqyrat financiare do të kryhet çdo vit, brenda gjashtë (6) muajve nga mbarimi i vitit financiar.

Neni 16

**PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISË**

- 16.1 Ortaku i Vetëm mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqërohet me likuidimin e saj.
- 16.2 Ortaku i Vetëm do të emërojë një ose me shumë likuidues, dhe përcakton tagrat e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 16.3 Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik vetëm për nevoja të likuidimit deri në përfundim të këtij procesi dhe gjatë likuidimit togfjalëshi “në likuidim e sipër” duhet të vihet pas emrit të Shoqërisë.

Neni 17

**LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

- 17.1 Ky akt bazohet në legjislacionin shqiptar dhe interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimi i tij, duhet të kryhen në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë akt do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar.
- 17.2 Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e këtij akti do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

*Ky akt përpilohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.*

**“HORIZON LIGHT INVESTMENTS” SH.P.K.**

**ORTAKU I VETEM**

**Erina Misha**



---